



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

Nr.1086/1Prot.

Shkodër, më 29.01.2019

Lënda: Jepet informacioni i kërkuar

Rruga: _____

Në vijim të kërkesës suaj Nr. 31, datë 22. 01. 2019, regjistruar në Bashkinë Shkodër me nr. 1086, datë 23. 01. 2019, në të cilën, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit, ju informojmë si më poshtë:

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit ”Për ngritjen e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, nr. 1506, datë 02.02.2017, Bashkia ka rolin drejtues dhe përgjegjësine e marrjes së masave për ngritjen, konsolidimin, monitorimin dhe vazhdimësinë me efektivitet të mekanizmit të referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në familje. Në këtë kuadër, Bashkia në përmbushjen e detyrimeve ligjore me qëllim ofrimin e një sërë shërbimeve bazë, në funksion të ngritjes së këtij mekanizmi, ka një punonjës në rolin e Koordinatorit Vendor. Deri në janar të vitit 2019, koordinatorë për çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare ka qenë punonjësja Jeta Xhabija.

Për monitorimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, është ngritur Komiteti Drejtues i cili përbëhet nga drejtues të të gjitha institucioneve dhe organizatave, pjesë e mekanizmit, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe zgjedhjen e përfaqësuesit të Institucionit tyre në ekipin teknik ndërdisiplinor, grup i cili përbëhet me përfaqësues teknikë të institucioneve të përfaqësuara në komitetin drejtues. Disa nga detyrat e Ekipit Teknik Ndërdisiplinor janë: ndjekja e rastit dhe plotësimin e nevojave të viktimave, duke siguruar edhe lidhjen e tyre me shërbimet e përshtatshme, menaxhimi i rasteve, etj.

KRYETAR

Voltana Ademi
